



## PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

### EMËRTIMI I AKTIVITETIT:

**PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI DHE RIKUPERIMI I MBETJEVE JO TE  
RREZIKSHME.**

### VENDODHJA:

**QARKU KORÇË, BASHKIA POGRADEC, NJËSIA ADMINISTRATIVE UDENISHT,  
FSHATI MEMLISHT, POLIGONI PARAFABRIKAT GURI I KUQ ME AMBJENT ME  
NR. PASURIE 731/48, ZONA KADASTRALE 2648.**

(Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 52/2020, date 30.04.2020 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, Industria minerare, ID 3.1.e. Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikeve, paletave, etj; Menaxhimi i mbetjeve ID 5.4. c. Rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme. Të gjitha instalimet Leje Mjedisi Tipi B.)

### Kërkues:

**Subjekti "INFINIT" Shpk, NIPT: J74304623M**

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga Studio:

**"GREEN Solution"**

Laert Shehu



Dhjetor, 2020

**TABELA:**

**STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN KY RAPORT I VNM**

<b>1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHE TË ZBATOHE PROJËTI.....</b>	<b>2</b>
<b>2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJËTI DHE NË AFËRSI TË SAJ. ....</b>	<b>16</b>
<b>3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS. ....</b>	<b>21</b>
<b>4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS. ....</b>	<b>29</b>
<b>5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.....</b>	<b>29</b>
<b>6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.....</b>	<b>29</b>
<b>7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME. ....</b>	<b>30</b>
<b>8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....</b>	<b>30</b>
<b>9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJËTI KA NATYRË TË TILLË). ....</b>	<b>33</b>

## 1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

Aktiviteti “Prodhimi i produkteve prej betoni dhe rikuperimit te mbetjeve jo te rrezikshme” ndodhet në Qarkun Korçë, Bashkia Pogradec, Njesia Administrative Udenisht, fshati Memlisht, Poligoni parafabrikat Guri i Kuq me ambjent me nr pasurie 731/48 dhe zona kadastrale 2648. Relievi i vendit te instalimit eshte i sheshte. Nuk kemi vleresim te siperfaqes bimore pasi ne pronen ku zhvillohet aktiviteti nuk gjendet bimesi. Persa i perket bimesise se zones, ajo eshte e perbere kryesisht nga toka bujqesore. Llojet e bimesise jane ato barishtore, ndersa kulturat bujqesore qe kryesisht kultivohen ne kete zone jane kryesisht dritherat te tilla si: Gruri, misri, jonxha, tershera, etj, si edhe pemet frutore si mollet, kumbulla, dardha, etj. Relievi i rajonit te Korçes eshte fushor, kodrinor-malor dhe malor. Siperfaqja qe eshte zene nga objekti nuk ben pjese ne siperfaqet pyjore te rajonit dhe nuk ka demtuar bimesine pyjore.

Ortofoto te bimesise se zones ne te cilen zhvillohet aktiviteti





### **Biodiversiteti**

**(Referuar Raportit te gjendjes se mjedisit per vitin 2019, Agjencia Kombetare e Mjedisit).**

Shqipëria është e njohur për shumëllojshmërinë e saj të lartë të burimeve gjenetike, specieve dhe ekosistemeve. Njihet gjithashtu si një vatër e rëndësishme biodiversiteti në Evropë me një diversitet të lartë ekosistemesh dhe habitatesh si dhe me një numër të madh llojesh sub-endemike, endemike, të rralla dhe të rrezikuara globalisht prezente në territor. Brenda territorit të saj gjenden ekosisteme detare, zona bregdetare, liqene, lumenj, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje gjethegjerë dhe pyje halorë, kullota alpine e subalpine dhe livadhe, si dhe ekosisteme të larta malore. Ky diversitet i atribuohet pozicionit gjeografik të vendit si edhe karakteristikave të relievit, tokës, klimatike, hidrologjike dhe gjeologjike. Terreni malor i kombinuar me shkëmbinj të thepisur ka krijuar kushte ideale për mirembajtjen dhe mbrojtjen e një sërë specimesh relikte, disa prej të cilave endemike ose sub-endemike. Gjëndja e biodiversitetit prezantohet me të dhënat e monitorimit të llojeve bimore e shtazore dhe rritjen e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura e monitorimin e biodiversitetit brënda tyre. Moment i rëndësishëm në kuadrin ligjor për biodiversitetin është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 31 datë 20.01.2016 “Për Miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit” në këtë dokument të rëndësishëm jepen planet konkrete të veprimit dhe strategjia që do të ndiqet për mbrojtjen e tij. Shqipëria gjëndet në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit dhe karakterizohet nga një klimë mesdhetare në ultësira dhe lugina, si dhe kontinentale e të ftohtë në lartësitë veriore dhe lindore. Edhe pse një vend i vogël, Shqipëria, shquhet për larmi të peizazheve e atyre biologjike dhe radhitet ndër vendet me biodiversitet të lartë në Evropë. Sipërfaqja e Shqipërisë, parë në aspektin gjeofizik dominohet nga kodra dhe male në pjesën lindore e veriore dhe zonën e ulët në pjesën perëndimore.



Pjesë me rëndësi në Republikën e Shqipërisë është “Ultësira perëndimore”, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga liqeni i Shkodrës në veri deri në qytetin e Vlorës në jug. Veç daljes në det, kjo ultësirë përshkohet nga veprimtaria e lumenjve kryesorë, të cilët përgjithësisht rrjedhin nga lindja në perëndim. Bregdeti shqiptar është 476 km i gjatë, ndërsa deti Adriatik dhe Jon kanë një ndikim të madh mbi klimën, florën dhe faunën e vendit. Zona veriore e Shqipërisë ka një reliev malor dhe karakterizohet nga një diversitet i formacioneve shkëmbore që nga koha e Paleozoikut. Pjesa më e madhe e vendit është zonë malore, ndërsa lartësia ulet duke fi lluar nga lindja në perëndim të vendit dhe kjo përcakton kushtet e klimës, tokës dhe vegetacionit. i gjithë peizazhi i sotëm është rezultat i zhvillimit gjeologjik gjatë lëvizjeve tektonike dhe neotektonike. Përgjatë bregdetit të vendit ka shumë ekosisteme të rëndësishme në rajonin e Mesdheut, si: lagunat, sistemet ligatinore, dunat ranore, deltat e lumenjve, pyjet dhe hygrophilet. Komunitetet bregdetare dhe infralitorale me origjinë mesdhetare përgjatë bregdetit shkëmbor janë mjaft të ndryshme dhe të ruajtura mirë. Liqenet dhe lumenjtë janë, gjithashtu, të rëndësishme për larminë biologjike dhe peizazheve të vendit.

### Të dhëna të përgjithshme për biodiversitetin

Në Shqipëri hasen përafërsisht 7233 grupime bimore (duke përfshirë fieret, kërpurdhat, likenet, myshqet dhe algat) si dhe 5438 lloje të faunës së egër (duke përfshirë shpezët, gjitarët, peshqit, insektet, molusqet etj). Në vendin tonë takohen përafërsisht 32 % e florës evropiane, kurse pyjet e lartë tek ne përbëjnë një habitat të rëndësishëm për gjitarët si psh. ariu i murrmë (*Ursus arctos*), derri i egër (*Sus scrofa*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), si dhe shumë lloje shpezësh. Komuniteti i pasur i gjallesave detare është një tregues i përqindjes së lartë i ruajtjes dhe cilësisë së këtyre komuniteteve në vendin tonë. Për vite me rradhë janë hasur afërsisht 70 lloje shpezësh ujorë me një popullatë të përafërt prej 180.000 individësh gjatë sezonit dimëror. Në Shqipëri takohen rreth 91 lloje që rrezikohen në shkallë globale dhe këtu futen: pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*), bretkosa shqiptare (*Pelophylax shqipericus*) si dhe bliri (*Acipinser sturio*), lloje për të cilat vendi ynë është areal me rëndësi të veçantë.

Biodiversiteti në Shqipëri		
Nr.	Grupimet bimore/ shtazore	Sasia e llojeve
1.	Bimë	7233
2.	Fauna e egër	5438
3.	Shpendë ujorë	70
4.	Lloje të rrezikuara në shkallë globale	91
5.	Llojet invazive	47
Totali		12879

Po ashtu kemi 47 lloje invazive që janë rregjistruar deri më tani. Ato u përkasin kryesisht: nematodave (krimbat e rrumbullakët)(1), molusqeve(1), insekteve(21), dekapodëve(2), peshqve(18) si dhe gjitarëve (5). Ndërkohë lidhur me gjendjen e florës, situata është më serioze. Egzistojnë rreth 196 lloje invazive të ciat janë përshtatur dhe kultivuar në mjedisin tonë, si edhe 81 lloje të natyralizuara plotësisht kurse 16 lloje janë bimë të dëmshme të natyralizuara, 11 lloje të mbetura si ish kultura bujqësore, 9 lloje relikte si dhe 38 lloje që përbëjnë lloje të reja të zbuluara, nga ku 41 lloje të introduktuara për të cilat supozohej dhe ishin rregjistruar si të zhdukura.

Biodiversiteti floristik sipas grupimeve bimore		
Nr.	Gender	Sasia
1.	Llojet invazive	196
2.	Llojet e natyralizuara plotësisht	81
3.	Bimë të dëmshme të natyralizuara pjesërisht	16
4.	Besohet se janë zhdukur	41
Totali		334

Lidhur me florën detare janë rregjistruar 186 lloje. Për më tepër, lista e bimëve të kërcënuara në nivel kombëtar është goxha e gjatë, dhe përfshin 319 lloje, 76 prej të cilave janë në një rrezik të vazhdueshmë, 123 të rrezikuara ndërsa 120 lloje të tjera në përkeqësim, që të gjitha të marra sëbashku përballen me një rrezik të lartë në nivel kombëtar. Në Shqipëri egzistojnë rreth 32 lloje bimësh endemike dhe përafërsisht 110 lloje sub-endemike, habitati i të cilave ndahet ndërmjet Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë dhe Greqisë.

Flora detare sipas grupimeve bimore		
Nr.	Statusi i kërcënimit	Sasia
1.	Nën rrezik të vazhdueshëm	76
2.	E rrezikuar	123
3.	Në përkeqësim të vazhdueshëm	120
Totali		319


Llojet endemike dhe sub-endemike		
Nr.	Lloji i endemizmit	Sasia
1.	Bimë endemike	32
2.	Bimë sub-endemike	110
Totali		142

Moratoriumi i gjuetisë i vendosur me ligjin Nr. 7/2014 “Per ndalimin e gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” deri në vitin 2016 dhe i shtyre për një periudhë të dyte deri në vitin 2021 ka bërë të mundur shtimin e numurit të një sere specieve të faunës së eger, kryesisht 59 llojet që kanë qenë objekt gjuetie.

Vitin e fundit të dhenat e sondazheve dhe monitorimit vitin e kaluar tregojnë:

- Praninë e zogjve shtegtarë në afërsi të bregdetit, gjë që tregon se ekziston paqe dhe është eliminuar në një masë të madhe gjuetia e paligjshme kushtëzuar afërsisht e tufave të këtyre specieve në bregdet;
- Praninë e disa specieve si shqiponja e ndotur e Madhe (*Aquila clanga*, *Clanga c.*) në Divjakë, ose pelikani kacurrell (*Pelecanus sp.*) në Velipojë, specie që nuk ishin raportuar për vite në këto zona;
- Praninë e shumtë e specieve të shpendëve shtegtarë është shtuar si rezultat i vendosjes në ligatinat në zbatim të moratoriumit të gjuetisë - ky konstatim tashmë është verifikuar nga kryerja e dy regjistrimeve të specieve migratore të dimrit në shkurt 2016 dhe janar 2017;

• Përveç zogjve shtegtarë, llojet e tjera të faunës së egër siç janë gjitarët e mëdhenj kanë një prirje në rritje të pranishmësi së tyre të konfirmuar nga prania e tyre në kamerat e bllokimit të vendosura për të identifikuar speciet e rralla të kërcënuara, siç janë rrezet ose vëzhgimet, shoqata të specializuara mjedisore në kuadrin e donatorëve projekte të financuara. Regjistrimi Ndërkombëtar i Rendit të Zogjve (IĒC) është një program ndërkombëtar që ka filluar në Shqipëri që nga viti 1993 (me një numër të kufi zuar të ekspertëve dhe fushave kryesore në studim). Në tre vitet e fundit, 2016, 2017 dhe 2018, Regjistrimi u krye me mbështetjen e Projektit Natyror (Programi IPA i BE) dhe me pjesëmarrjen e OJQ-ve dhe ekspertëve të fushës dhe stafi të AKZM-se. Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se numuri i zogjve në vitin 2019 është rreth 50% më i lartë se në vitin 2016.



Vendi ynë ka nivel të ulët të emetimit të karbonit nga industritë, trafiku, dhe burimet e tjera ndërkohë që mbulesa e tokës mbizotërohet nga vegetacioni duke na radhitur ndër vendet me nivel të lartë të sekuestrimit të karbonit nga ekosistemi natyror. Bregdeti Adriatik i Shqipërisë ka një potencial të mirë për mbrojtje nga rreziku i erozionit; kjo zonë kombinon një nivel të lartë të mbrojtjes nga erozioni me një ndjeshmëri të lartë për erozionin për shkak të shpatëve, tokave të ndjeshme dhe reshjeve erozive të kombinuara me përdorimin intensiv të tokës nga njerëzit (Schulp et al., 2012). Në mënyrë të ngjashme, zonat bregdetare, ligatinat dhe përmytjet paraqesin një mundësi të mirë për mbrojtje nga përmytjet përgjatë vijës bregdetare të Shqipërisë dhe lumenjve të shumtë. Ofrimi i shërbimeve: Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe specieve në Shqipëri siguron një gamë të gjerë të produkteve natyrore që kanë një vlerë të konsiderueshme ushqyese dhe/ose ekonomike. Zonat malore janë veçanërisht të rëndësishme për mbledhjen e bimeve të egra (Schulp et al., 2012). Ndër speciet me vlerë të lartë ekonomike, mund të gjenden 300 specie bimore medicinale dhe aromatike, 40 specie bimore foragjere, 50 bimë të njohura për prodhimin e mjaltit, 70 bimë të kultivuara.

Bimet aromatike mjekesore që grumbullohen		
Nr.	Statusi	Sasia
1.	Lloje aromatike-mjekesore	300
2.	Lloje foragjere	40
3.	Lloje për prodhimin e mjaltit	50
4.	Kultura bujqesore	70
<b>Totali</b>		<b>460</b>

### Të dhëna për speciet e kërcënuara dhe të mbrojtura të florës

Në VKM-në Nr. 31, datë 20.1.2016 për “Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për mbrojtjen e Biodiversitetit”, përfshihet aneksi 4, titulluar “LISTA E KUQE E FLORËS SHQIPTARE E PROPOZUAR OSE PRANUAR NGA IUCN”, me këtë përmbajtje:

N/R	Scientific name	IUCN status
1	<i>Aesculus hippocastamun</i>	NT Pranuor
2	<i>Anacamptis palustris</i> (Jacq.) R.M. Bateman	LC Pranuor
3	<i>Galanthus reginae-olgae</i> Orph & Pridgeon & Chase	VU B 2ab (iii.v) pranuar.
4	<i>Caldesia parnassiifolia</i> (L.)Parl.	LC Pranuor
5	<i>Carex markgrafii</i> Kiik.	VU D2 Propozuar
6	<i>Calcihcum macedonicum</i> Kosanin	EN C1 C2(ai)Propozuar
7	<i>Dactylorhiza cordigera</i>	LC Pranuor
8	<i>Festuka galicicae</i> Horvat ex Markgr. - Dann	EN B1+ B2ab(iii) Propozuar
9	<i>Fritillaria graeca</i> Boiss.	DD Pranuor
10	<i>Fritillaria gussichiae</i> (Degen & Doerfler)Rix	DD Pranuor
11	<i>Ophrys bertolonii</i> Moretii	LC Pranuor
12	<i>Ophrys insectifera</i> L.	LC Pranuor
13	<i>Marsilea quadrifolia</i> L.	LC Pranuor
14	<i>Ramonda serbica</i> Pancic	LC Pranuor
15	<i>Salvinia natans</i> (L) All	LC Pranuor

N/R	Scientific name	IUCN status
16	<i>Stipa mayeri</i> Martinovsky	EN B2ab(iii) Propozuar
17	<i>Tulipa albanika</i> Kit Tan & Shuka CR	CR B2ac(i,iv) Propopzuar
18	<i>Festucopsis serpentini</i> (C.E Hubb) Melderis	LC Propozuar
19	<i>Crocus acardicus</i> Kosanin	LC Propopzuar
20	<i>Gentiana panctata</i> L.	LC Pranuor
21	<i>Leontopodium alpinum</i> Cass	LC Pranuor
22	<i>Rhamnus intermedius</i> Steud. & Hochst	LC Pranuor
23	<i>Scilla albanica</i> Turill	NT Propozuar
24	<i>Sesleria wettsteinii</i> Dorfl & Hayek	DD Propozuar
25	<i>Sideritis scardica</i> Griseb.	NT Pranuor
26	<i>Solenanthus Albanica</i> Degen & Baldacci	EN B1ab(v)+2ab(v) Pranuor





### SHPJEGIMI I KATEGORISË SË RREZIKUT SIPAS IUCN-SË

<b>CR</b>	Rrezik kritik	Lloji është në rrezik të afërt zhdukjeje në natyrë
<b>EN</b>	Rrezikuar	Lloji përballet me një rrezik tejet të lartë zhdukjeje në natyrë
<b>VU</b>	Vulnerabël	Lloji përballet me një rrezik të lartë zhdukjeje në natyrë
<b>NT</b>	Gati i kërcënuar	Lloji nuk plotëson asnjë kriter që do ta kategorizonte që rrezikon zhdukjen, por a të ngjarë ta bëjë në të ardhmen
<b>LC</b>	Shqetësim i vogël	Nuk ka reziqe të tanishme të identifikueshme për llojin
<b>DD</b>	Të dhëna të pamjaftueshme	Ekziston informacion i pamjaftueshëm për të bërë një vlerësim të reziqeve të këtij lloji
<b>LR/cd</b>	Shqetësim më i ulët/varur nga ruajtja	Llojet të cilat kanë qenë fokus i programeve të ruajtjes dhe mund të jenë zhvendosur në një kategori me rrezik më të lartë nëse ai program do ndërpritej
<b>LR/nt</b>	Rrezik më i ulët/gati i kërcënuar	Llojet të cilat janë pranë klasifikimit si vulnerabël, por nuk janë object i programeve të ruajtjes
<b>LR/c</b>	Rrezik më i ulët/shqetësimi më i ulët	Llojet për të cilët nuk ka reziqe të identifikueshme

### SPECIET E KËRCËNUARA DHE TË MBROJTURA TË FLORËS

N/R	Scientific name	Kërcënuar Po/Jo	Mbrojtur Po/Jo	Shënime/Statusi i mbrojtjes
1	<i>Aesculus hippocastamun</i> (Gështenja e kalit)	Po	Po	NT
2	<i>Anacamptis palustris</i> (Jacq.) R.M. Bateman (Anakamptë moçalesh)	Po	Po	LC
3	<i>Galanthus reginae-olgae</i> Orph & Pridgeon & Chase (Boçëbore e mbretëreshës ollga)	Po	Po	VU
4	<i>Caldesia parnassiifolia</i> (L.)Parl. (Gjethe pamas)	Po	Po	LC
5	<i>Carex markgrafii</i> Kiik.(Presje e Margrafit)	Po	Po	VU
6	<i>Calchicum macedonicum</i> Kosanin (Lulepreshe)	Po	Po	EN
7	<i>Dactylorhiza cordigera</i> (Daktilrhizë kordigerë)	Po	Po	LC
8	<i>Festuca galicicae</i> Horvat ex Markgr. - Dann	Po	Po	EN
9	<i>Fritillaria graeca</i> Boiss. (Fritilare greke)	Po	Po	DD
10	<i>Fritillaria gussichiae</i> (Degen & Doerfler)Rix	Po	Po	DD
11	<i>Ophrys bertolonii</i> Moretii	Po	Po	LC
12	<i>Ophrys insectifera</i> L. (Ofris isektmbartës)	Po	Po	LC
13	<i>Marsilea quadrifolia</i> L. (Marsile katërgjethëse)	Po	Po	LC
14	<i>Ramonda serbica</i> Pancic (Ramondë e serbisë)	Po	Po	LC
15	<i>Salvinia natans</i> (L) All (Selvinie pluskuese)	Po	Po	LC
16	<i>Stipa mayeri</i> Martinovsky	Po	Po	EN
17	<i>Tulipa albanica</i> Kit Tan & Shuka CR (Tulipani shqiptar)	Po	Po	CR
18	<i>Festucopsis serpentini</i> (C.E Hubb) Melderis (Festukops i serpetinës)	Po	Po	LC
19	<i>Crocus scardicus</i> Kosanin (Shafrani i sharrit)	Po	Po	LC
20	<i>Gentiana panchata</i> L.(Gencilinë pikaloshe)	Po	Po	LC
21	<i>Leontopodium alpinum</i> Cass	Po	Po	LC
22	<i>Rhamnus intermedius</i> Steud. & Hochst	Po	Po	LC
23	<i>Scilla albanica</i> Turilli (Boçkë shqiptare)	Po	Po	NT
24	<i>Sesleria ättesteinii</i> Dorfl & Hayek (Pirë e Vetshtajnit)	Po	Po	DD
25	<i>Sideritis scardica</i> Griseb. (Siderit i Sharrit)	Po	Po	NT
26	<i>Solenanthus Albanica</i> Degen & Baldacci (Solenantë e Shqipërisë)	Po	Po	EN

## Pyjet

Pyjet janë pasuri natyrore me rëndësi jetike me shtrirje në të gjithë botën, duke u bërë kështu një e mirë efektive pa dallim ndarje kufiri. Pyjet zënë rreth 1/3 e sipërfaqes së tokës, me rreth 4 miliard ha, duke pësuar humbje gjatë viteve. Një pjesë e konsiderueshme e sipërfaqes pyjore shtrihet në Evropë me rreth 180 milionë ha, duke e bërë një nga rajonet më të pasura me pyje, me më shumë se 40% të tokës të mbuluar prej tyre. Në rajonin e Ballkanit, sipërfaqja është 30 milion ha, e cila përbën 23% të sipërfaqes totale të rajonit. Sipërfaqja pyjore në Shqipëri është rreth 1 milion ha, duke zënë rreth 36% të sipërfaqes së vendit, me një mesatare prej 0.36 ha/banor. Kjo shifër është relativisht mesatare krahasuar me vendet e tjera të rajonit, ku Mali i Zi e ka më të lartën me 0.9 ha/banor, Kroacia me 0.44 ha/banor dhe Serbia me 0.3 ha/banor. Volumi i lëndës drusore i përlogaritur është rreth 55 milion m<sup>3</sup>, me një rënie prej 20 milion m<sup>3</sup> nga viti 2005, duke ulur kështu cilësinë e pyjeve tona dhe duke na karakterizuar si një “vend i pasur me pyje të varfër”. Në vitet e fundit, pyjet kanë zënë një vend gjithmonë në rritje në axhendën politike dhe prioritetet e qeverisjes, duke kuptuar rëndësinë e pyjeve për cilësinë e jetës, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe ekuilibrat natyrorë. Sipas struktures fondit pyjor përbëhet nga 36% trungishte, 28% cungishte dhe 36% shkurre. Nga të dhënat e INSTAT rezulton se 14% e sipërfaqes së fondit pyjor zihet nga pyjet halore (ku 9% është pishë e zezë, 1% bredh dhe 4% halorë të tjerë). Pjesa më e madhe e sipërfaqes së fondit pyjor përkatësisht 50% zihet nga fletorët (16% ah, 29% lis, 0.17% plepa dhe pjesa tjetër nga fletorët e tjerë). Ndërsa 36% zihet nga shkurret (ku shkoza ka 12.6% të sipërfaqes, maret 9% dhe shkurret e tjera 14.23%). Sipas klasave të moshës kemi 22% trungishte me moshë mbi 100 vjet, 6% cungishte me moshë mbi 40 vjet dhe 30% shkurre me moshë mbi 20 vjet. Vihet re që si pasojë e mbishfrytëzimit, vendi ynë karakterizohet nga pyje me moshe relativisht të re. Vëllimi i llogaritur për të gjithë sipërfaqen pyjore është rreth 55 milion m<sup>3</sup> lëndë druri në këmbë, rreth 84% e vëllimit drusor është përqëndruar në pyjet e lartë, afro 10% në pyjet e ulët dhe 6% në shkurre.

## Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura mjedisore


Në Republikën e Shqipërisë, zonat e mbrojtura janë shpallur, me VKM – të përkatëse, bazuar në Ligjin nr.8906 “ Për Zonat e Mbrojtura”, datë 06.06.2002, (të ndryshuar) dhe me hyrjen në fuqi të ligjit 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”. I gjithë sistemi i zonave të mbrojtura, që përfshin aktualisht 18% të territorit të vendit, është përcaktuar sipas kriterëve të IUCN –së, në gjashtë kategori kryesore:

### *Kategoritë e Zonave të Mbrojtura dhe sipërfaqet respektive*

Nr.	Emërtimi i kategorisë së zonës së mbrojtur	Nr.	Kategoria	Sip. në Ha
1	Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor	2	I	4 800
2	Park Kombëtar	14	II	230,707. 2558
3	Monument Natyre	723	III	3 470.0
4	Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror	25	IV	169,275. 42
5	Peizazh i Mbrojtur	6	V	97,333. 639
6	Zonë e Mbrojtur e Burimeve Natyrore të Menaxhuara/me përdorim të shumëfishtë	4	VI	18, 245.0
	<b>Totali</b>	<b>776</b>		<b>523,831. 31</b>

Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura mjedisore përfaqësohet nga numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura që është 776 (duke përfshirë edhe monumentet e natyrës), dhe zë një sipërfaqe prej më shumë se 523,831 hektarësh ose rreth 18 % të territorit të Shqipërisë. Në këtë shifër përfshihen edhe territoret bregdetare, si dhe zona detare e Sazan-Karaburunit. Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura është bërë në mënyrë të konsiderueshme që nga strategjia e plani i veprimt të biodiversitetit, të vitit 2000. Duke nisur nga viti 2005 numri i zonave të mbrojtura është rritur më shumë se dy herë, nga 5% në më shumë se 18 %. Harta dhe të dhënat kryesore për ZM-të janë paraqitur respektivisht në anekset 8 dhe 9. Rrjeti aktual i zonave të mbrojtura përfshin 119.401 ha sipërfaqe bregdetare dhe 13.261 ha sipërfaqe detare. Zona e parë detare e mbrojtur në Shqipëri është shpallur në prill të vitit 2010, Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan. Në listën Ramsar të ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, si habitate ujore me rëndësi për shpendët e ujit janë: 1) Laguna e Karavastasë; 2) Kompleksi ligatinor i Butrintit; 3) Liqeni i Shkodrës dhe Kompleksi ligatinor i lumit Buna; dhe 4) liqenet Zona e Prespës, e shpallur si zona e 4-t Ramsar në Shqipëri, me VKM-në nr. 489, datë 13.6.2013. Shtojca 10 tregon vendndodhjen e zonave Ramsar në hartën shqiptare. Konventa për ligatinat hyri në fuqi për Shqipërinë, më 29 shkurt të vitit 1996. Shqipëria aktualisht ka 4 zona të përcaktuara si ligatina me rëndësi ndërkombëtare, me një sipërfaqe prej 98.181 hektarësh. Zona e Liqenit të Prespës, duke përfshirë dhe Liqenin e Ohrit u propozua, në vitin 2013, si Rezerva e Parë Biosferike për Shqipërinë. Këshilli Internacional i Koordinimi të Programit të UNESCO-s në një seancë të mbajtur në Jönköping-Suedi, më 11.6.2014 (biosfera dhe njeriu) miratoi propozimin për të quajtur rajonin e Ohrit dhe të Prespës si një rezervë ndërkufi tare biosferë. Vlen për t'u theksuar sic vihet re dhe nga grafiku i mëposhtëm se në përdorimin e territorit për Zonat e Mbrojtura mbizotërojnë ekosistemet pyjore, vecanërisht në Parqet Kombëtare që gëzojnë statusin e shkallës së dytë të mbrojtjes. Pyjet te konsideruara si shfaqja me e larte e biodiversitetit zene rreth 45% te gjithe territorit.

Grafiku i perdorimit të territorit për të gjitha kategoritë e ZM




**Burimi i informacionit:** Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2019, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit (Faqja Zyrtare).

Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbtohet projekti përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

**Siperfaqja qe prek projekti i propozuar, nuk ben pjese ne zone te mbrojtur. Ky informacion, eshte qjeneruar nga qjeoportali shteteror: asiq. gov.al.**

Nga verifikimet paraprake me informacionet që disponojmë, është identifikuar se zona ku ushtrohet aktiviteti ben pjese ne zonat e mbrojtura dhe me status te veçante. Gjithashtu, ne afersi te objektit ndodhen edhe zona te mbrojtura te llojit monument natyre, por distance e ketyre te fundit eshte mbi 1.5 km. Vete prona ne vleresim, ndodhet ne brendesi te zones se mbrojtur “Liqeni i Pogradecit”.

**Imazh satelitor i zones dhe distances qe ruan projekti me zonen e mbrojtur te rajonit.**




**Per informacion me te sakte, zhvilluesi, ose institucionet aprovuese te projektit, mund te paraqesin kerkese per verifikim prane AKZM per verifikime me te detajuara dhe me te sakta**

### Monumentet Natyrore te Rrethit Korçe (sipas VKM Nr. 303, date 10.05.2019)

Monumenti	Statusi	Bashkia	Gjendja_MN
<b>QARKU KORÇË</b>			
Ahishtet e Bofjes	E ruan	MALIQ	E mire
Ahishtet e Protopapes Opar	E ruan	MALIQ	E mire
Ahishtja e Bradvices	E ruan	DEVOLL	E mire
Ahishtja e Shen Kostandinit	E ruan	DEVOLL	E mire
Banjat e Avulit Postenan	E ruan	KOLONJE	E mire
Bokrimat e Piskalit	E ruan	KOLONJE	E mire
Bookerrimat e Moglices	E ruan	MALIQ	E mire
Bredhi i Shtikës	E ruan	KOLONJE	E mire
Bredhi i Vishnjës	E ruan	KORÇË	E mire
Burim uji dhe gazi të djegshem në thyerjen tektonike të Polenës	E ruan	KORÇË	E mire
Burimet e PROGRIT	E ruan	DEVOLL	E mire
Burimet Termale te Vromonerit	E ruan	KOLONJE	E mire
Burimi i Drilonit	E ruan	POGRADEC	E mire
Dafina e Cerckes	E ruan	KOLONJE	E mire
Dritarete Mbuleses Tektonike Qinam Vodice	E ruan	KOLONJE	E mire
Dushkaja e Dobrogovës	E ruan	DEVOLL	E mire
Dushqet e Manastirit	E ruan	PUSTEC	E mire
Fragment i shkeputjes tektonike Pogradece	E ruan	POGRADEC	E mire
Grumbulli i Plepit te eger Varishte	E ruan	KOLONJE	E mire
Gurët Mumjet e Trenit	E ruan	DEVOLL	E mire
Guret Nusja dhe Dhendri	E ruan	POGRADEC	E mire
Guri i Ariut Ecmenik	E ruan	DEVOLL	E mire
Guri i Cjapit	E ruan	DEVOLL KORÇË	E mire
Guri i Kamjes	E ruan	POGRADEC	E mire
Guri i Prerë	E ruan	MALIQ SKRAPAR	E mire
Ishulli i Maligradit	E ruan	PUSTEC	E mire
Kanioni i Virkes	E ruan	KOLONJE	E mire
Kanioni i Ljenges	E ruan	POGRADEC	E mire
Koria e Shen Kollit Vodice	E ruan	KOLONJE	E mire
Korria e Mullirt Gostivisht	E ruan	KOLONJE	E mire
Ligenet e Lenies	E ruan	MALIQ	E mire
Ligenet e Lukoves	E ruan	POGRADEC	E mire
Lisat e Shen Kollit Lengez	E ruan	KOLONJE	E mire
Lisat e Shënthanasit Polene	E ruan	KORÇË	E mire
Manat e kishes SHEN VANGJELIZMO-GOLLOMBOC	Propozim për MN	PUSTEC	E mire
Mani e Shen Marenes	E ruan	POGRADEC	E mire
Mecka e Benjezit	Propozim për MN	KOLONJE	E mire
Mospërputhja këndore e Polenës	E ruan	KORÇË	E mire
Mulleret e gurte Trebinje	E ruan	POGRADEC	E mire
Piramidet e tokes se Xhombrit	E ruan	MALIQ	E mire
Pisha e Makrezës	E ruan	KORÇË	E mire
Pisha e Pogonices (Sotire Radanj)	E ruan	KOLONJE	E mire
Pisha e Shendellise	E ruan	KORÇË	E mire
Pishat e Voskopojës	E ruan	KORÇË	E mire
Plepat e Pifurit	E ruan	DEVOLL	E mire
PYLLI I SHEN VASILIT-LESKA(LAJTHIZE)	Propozim për MN	PUSTEC	E mire
Pylli i Shënthanasit	E ruan	DEVOLL	E mire
Rrapi i Leskovikut	E ruan	KOLONJE	E mire
Rrapi i Mbreshtanit	E ruan	KOLONJE	E mire
Rrapi i Qytetit (Shënmëria)	E ruan	KORÇË	E mire
Rrapi i Rrodokalit	E ruan	POGRADEC	E mire
Rrapi i Selces se Siperme	E ruan	POGRADEC	E mire
Rrepet e Glines	E ruan	KOLONJE	E mire
Rrepet e Tushemishtit(Sallekemi i Tushemishtit)	E ruan	POGRADEC	E mire
Rrobujt e Badres	E ruan	KOLONJE	E mire
Rrobulli i kuq	E ruan	MALIQ	E mire
Rrobulli i Lenies	E ruan	MALIQ	E mire
Selvia e kishes Fjetja e Shën Mërisë në qytetin e Pogradecit	E ruan	POGRADEC	E mire
Selvitë e Radovës	E ruan	KOLONJE	E mire
SHKEMBI "ZAREZATA STENA"(SHKEMBI I PRERE)-ZAROSHKE	Propozim për MN	PUSTEC	E mire
Shparthi i Osojes Bakullit	E ruan	MALIQ KORÇË	E mire
Shpella e Baribardhes	E ruan	POGRADEC	E mire
Shpella e Memelishtit	E ruan	POGRADEC	E mire
Shpella e Najazmës	E ruan	POGRADEC	E mire
Shpella e Podes	E ruan	KOLONJE	E mire
Shpella e Rrodokalit	E ruan	POGRADEC	E mire
Shpella e Shen Marenes	E ruan	POGRADEC	E mire
Shpella e Trenit	E ruan	DEVOLL	E mire
Tisi i Golas	E ruan	KOLONJE	E mire
Travertinat (Cmerset) Blush	E ruan	KOLONJE	E mire
Ujvara e Rehoves	E ruan	KOLONJE	E mire
Vakefi Pesar i Zi	Propozim për MN	KOLONJE	E mire
Varreza e fosileve të kretës se poshtëme të Voskopojës	E ruan	KORÇË	E mire
Vënjat e Kallamasit	E ruan	PUSTEC	E mire
Zgavra e Zaverit	E ruan	PUSTEC	E mire
Pylli i perziere i Maliqit (Pylli i fazaneve)	E ruan	MALIQ	E mire

## Zonat e Mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)



PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI DHE RIKUPERIMI I MBETJEVE JO TE RREZIKSHME.  
KORÇË, POGRADEC, NJ.A. UDENISHT, MEMLIHT, POLIGONI PARAFABRIKAT GURI I KUQ ME NR. PAS 731/48, ZK 2648.

RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHQIPËRI

MINISTRIA E MJEDISIT						VITI 2014-JANAR	
Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3.000.0
2	I	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.800.0
<b>SHUMA I Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)</b>						<b>2</b>	<b>4.800.0</b>
3		Shkodër	Shkodër	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2.630.0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.280.0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.010.0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.380.0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8.000.0
9	II	Durrës	Krujë	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2.000.0
10	II	Dibër	Mat	Zali Gjoçaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140.0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27.750.0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butrinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9.424.4
13	II	Tiranë, Durrës		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29.216.9
		Tiranë	Tiranë	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26.772.7
		Durrës	Krujë	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2.444.2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22.230.2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19.411.1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2.074.5
		Tiranë	Kavajë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744.6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33.927.7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33.760.1
		Diber	Bulqizë	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167.6
16	II	Gjirokastrë, Korçe		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008	1	34.361.1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		33.165.3
		Korçe	Kolonjë	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		1.195.6
17	II	Vlorë	Vlorë	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, datë 28.04.2010	1	12.428.0
	II	Berat, Elbasan		Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24.723.1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8.398.4
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15.045.8
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1.278.9
<b>SHUMA II Park Kombetar - Kategoria II (PK)</b>						<b>15</b>	<b>210.501.4</b>
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	348	0.0
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	398	0.0
	III			<b>ShumaBio&amp;Gjeo Nr.</b>		<b>746</b>	<b>0.0</b>
21	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.740.0
22		Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.500.0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syri i Kaltër	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	180.0
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	50.0
				Shuma MonNatyre Nr.		<b>4</b>	<b>0.0</b>
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676, datë 20.12.2002	<b>750</b>	<b>0.0</b>
<b>SHUMA III Monument Natyre - Kategoria III (MN)</b>							<b>3.470.0</b>
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20.000.0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafllak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kuturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3.600.0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1.500.0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0
33	IV	Berat	Berat	Ballolli	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkuil	Urdhër MB nr.2, datë 26.12.1995	1	650.0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrëzomë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.400.0
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	30.0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gëmenj-Shelegur	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	430.0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	45.0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	300.0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liçeni i Shkodrës	VKM nr. 684, datë 02.11.2005	1	26.535.0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vain-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4.393.2
45	IV	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5.000.7
46	IV	Diber, Kukës		Korab-Kortinik	VKM nr.898, datë 21.12.2011	1	55.550.2
		Diber	Diber	Korab-Kortinik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		20.663.4
		Kukës	Kukës	Korab-Kortinik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		34.886.6
<b>IV/1 Park Natyror Rajonal</b>							
47	IV/1	Diber	Mat	Liçeni i Ulzez dhe zona perreth tij	VKQ nr. 16, datë 03.04.2013	1	4.206.0
<b>SHUMA IV Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)</b>						<b>23</b>	<b>127.180.1</b>
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	510.0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27.323.0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjoshë-Nartë	VKM nr.680, datë 22.10.2004	1	19.738.0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682, datë 02.11.2005	1	23.027.0

PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI DHE RIKUPERIMI I MBETJEVE JO TE RREZIKSHME.  
KORÇË, POGRADEC, NJ.A. UDENISHT, MEMLIHT, POLIGONI PARAFABRIKAT GURI I KUQ ME NR. PAS 731/48, ZK 2648.

52	V	Tiranë, Diber, Elbasan		M. Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M. Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M. Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqizë	M. Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
<b>SHUMA V Peizazh i Mbrojtur - Kategoria V (PM)</b>						<b>5</b>	<b>95,864.4</b>
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Gun i Nikës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,200.0
<b>SHUMA VI Zone e Mbrojtur e Burimeve të Natyrore të Menaxhuara - Kategoria VI (ZBNM)</b>						<b>4</b>	<b>18,245.0</b>
<b>TOTALI I ZM</b>						<b>16%</b>	<b>799</b>

Sip. Republikës	2.874.800.00	ZM pa Sip.Detare	15.54%	446,799.7
		Sip. Detare, Ha	0.5%	13,261.2
		Karaburun-Sazan		12,428.0
		Butrint		833.2
		Sip. Bregdetare dhe Detare	%Totalit ZM	25.95%
				119,401.5

**Shkurtesat:**

a	VKM	Vendim i Keshillit të Ministrave		
b	VKQ	Vendim i Keshillit të Qarkut		
c	MB	Ministria e Bujqësisë		
d	ZM	Zone e Mbrojtur		

**LISTA E ZONAVE RAMSAR**

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413, datë 22.08.1994	Nr. Site 761, dt. 29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepl Stillos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr. Site 1290, dt. 28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liqeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr.663, datë 02.11.2005	Nr. Site 1598, dt. 2.2.2006	49,562.0
4	RAMSAR	Korce	Korce, Devoll	Liqeni i Prespave	VKM nr. 489, dt. 13.06.2013	Nr. Site 2151, dt. 03.07.2013	15,118.6
<b>TOTALI</b>						<b>%Totali Republikës</b>	<b>3.42%</b>
							<b>98,180.6</b>

DREJTORIA PYJEVE DHE BIODIVERSITETIT  
SEKTORI I BIODIVERSITETIT DHE ZONAVE TË MBROJTURA  
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.  
[www.mjedisi.gov.al/](http://www.mjedisi.gov.al/)

**Monumentet e kultures se rrethit Pogradec**

<b>RRETHI I POGRADECIT</b>									
NR	EMRI I MONUMENTIT	FSHATI	KOMUNA	BASHKIA	RRETHI	KATEG	INSTITUCIONI I SHPALLJES	NR. VENDIMI	VITI SHPALLJES
1	KALAJA E POGRADECIT			POGRADEC	POGRADEC	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
2	KALAJA E BLLACES	BLLACE	CERRAVE		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
3	KALAJA E ZEMÇES ne fshatin Zemce	ZEMÇE	TREBINJE		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
4	GRADISHTA ne fshatin Selce e Poshtme(Moker) ne lugnen e sipërme te shkumbinit, ne anë te djathtë te tij, ne kuotën 812 deni ne 50 metra rreth e perqark pllatis duke perfshire edhe varrin ne shkemb te quajtur Qori i Begos.	SELCE E POSHTME	TREBINJE		POGRADEC	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
5	GRADISHTA ne fshatin Sllabinje	SLIABINJE	PROPTISHT		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
6	VENDBANIMI PREHISTORIK ne kodren e fshatit Zagradia	ZAGRADIA			POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
7	SHKEMBI I QYTETIT ne shpelle te Mokres	SHPELLA E MOKRES			POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
8	URA MIDIS FSHATRAVE JOLLE E LLENGE	JOLLE / LLENGE	VELCAN / TREBINJE		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
9	URA NE FSHATIN Golik	GOLIK	PROPTISHT		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
10	URA NE FSHATIN Nice	NIÇE	DARDHAS		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
11	URA NE FSHATIN Cezme	ÇEZME	TREBINJE		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
12	URA NE FSHATIN Zgalle	ZGALLE			POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
13	URA NE FSHATIN Servertine	SERVERTINE			POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
14	URA NE FSHATIN Dunice	DUNICE			POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
15	URA E TERZIUT ne fshatin Propisht	PROPTISHT	PROPTISHT		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
16	MANASTIRI I SHEN MARENES . Afer fshatit Llenge (Moker). Godina me nje distance prej 10 metra larg mureve.	LLENGE	TREBINJE		POGRADEC	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
17	RRENOJAT E KISHES PALEOKRISTIANE DHE MOZAIKET ne fshatin Lin	LIN	UDENISHT		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973



18	<b>RRENOJAT E KISHES BIZANTINE PRANE STACIONIT TE PESHKIMIT</b> ne fshatin Lin	LIN	UDENISHT		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973	
19	<b>MOZAIKU</b> ne fshatin Tushemisht	TUSHEMISHT	BUCIMAS		POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973	
20	<b>MOZAIKU I LINIT</b>	LIN			POGRADEC	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973	
21	<b>BANESA E ARIF SELAUDIN BIÇOKUT-</b> Derdush, Pogradec. Eshte nje shembull i rralle dhe me mjaft vlerë i baneses me kulle per ate zone.	DËRDUSH			POGRADEC	I	Komiteti i Kulturës dhe i Arteve	8	18.12.1987	
22	<b>BANESA E VËLLEZËRVE ICKA, Lagja "Burimeve",</b> Pogradec. Ben pjesë ne ansamblin e Pazarit te Vjeter te Pogradecit. Banese me vlera si per kompozimin e vecante ashtu edhe per trajtimin e jashtem arkitektonik.				POGRADEC	POGRADEC	I	Komiteti i Kulturës dhe i Arteve	8	18.12.1987
23	<b>BANESA E VËLLEZËRVE KUÇUKU L" Burimeve",</b> Pogradec. Nderim tipik tregu. Ne katin perdhe jane vendosur punishtet, dyqanet ndera ne katin e siperm mjediset e familjes.				POGRADEC	POGRADEC	I	Komiteti i Kulturës dhe i Arteve	8	18.12.1987
24	<b>BANESA E POETIT LASGUSH PORADECI</b>				POGRADEC	POGRADEC	I	Komiteti i Kulturës dhe i Arteve	5	23.11.1988
25	<b>BANESA E KRISTAQ PUÇES L."Burimeve",</b> Pogradec. Eshte banese "Vellazerishte" me kompozim planimetrik dhe paisje te mjedisve simetrike.				POGRADEC	POGRADEC	I	Komiteti i Kulturës dhe i Arteve	8	18.12.1987
26	<b>BANESA E RINKO GUXHOS Lagja "Burimeve",</b> Pogradec. Nderim tre katesh me nje mjedis ne cdo kat. Ne trajtimin e jashtem te bie ne sy dhe hedhja ne lartesi, nxjerrja perpara e ballit te katit te trete si dhe elementet arkitektonik te perpunuar.				POGRADEC	POGRADEC	I	Komiteti i Kulturës dhe i Arteve	8	18.12.1987
27	<b>BANESA E SANDRI QIPROS Lagja "Burimeve",</b> Pogradec. Nderim dy katesh me vlera ne trajtimin e pamjes se jashtme si dhe kompozimin planimetrik.				POGRADEC	POGRADEC	I	Komiteti i Kulturës dhe i Arteve	8	18.12.1987
28	<b>BANESA E MARO MOKRËS</b> -ne fshatin Potgozhan(Pogradec). Kjo shtepi ka qene baze e luftes Antifashiste Nacional Cilirimtare ne Qershor te vitit 1943, ketu eshte strehuar shoku Enver Hoxha.	POTGOZHAN			POGRADEC		Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	957/1	29.04.1983	
29	<b>ZONA ARKEOLOGJIKE"A" E GRADISHTES SE SELCES,DHE MIRATIMI I RREGULLORES SE ADMINISTRIMIT</b>	SELCE	PROPTISHT		POGRADEC	I	KËSHILLI I MINISTRAVE	788	29.09.2010	


**Burimi i informacionit: Ministria e Kulturës**

## 2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.


Ne zonen e ushtrimit te ketij aktiviteti ka burime ujore te identifikuar. Aktiviteti ne vleresim ndodhet ne Qarkun Korçë, Bashkia Pogradec, Njesia Administrative Udenisht, fshati Memlisht, poligoni parafabrikat me ambjent me nr pasurie 731/48, zona kadastrale 2648 dhe ndodhet ne afersi te burimit ujore kryesor te zones siç eshte Liqeni i Ohrit.

Burimi ujqor me i rendesishem, Liqeni i Ohrit ndodhet ne afersi te zones ku ndodhet aktiviteti rreth 80 m larg ne vije ajrore nga siperfaqja ku ushtrohet aktiviteti ne lindje te tij. Sipas deklarimeve te subjektit, ujerat e perdorura gjate ushtrimit te aktivitetit nuk shkarkohen ne mjedisin e afert ujqor, ne Liqenin e Ohrit.

**Distanca qe ruan aktiviteti me burimet ujore te zones**



**Fragment nga Studimi Urbanistik i Bashkise Pogradec  
Aktiviteti zhvillohet ne njesine strukturore PG/HU20**



## **Cilësia e ujërave në vendin tonë**

### **(Informacione të përgjithshme bazuar në studimin Kombëtar vjetor të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit)**

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara.

## **LIQENI I OHRIT**

Monitorimi i Liqenit të Ohrit është realizuar vetëm në stacionin litoral 200 m nga bregu, përballë qytetit, në thellesi mbi 5 metra, pasi për arsye të mungesës së varkës është realizuar vetëm ekspedita I. Liqeni i Ohrit karakterizohet nga fenomeni i shtresëzimit, për shkak të thellesisë së tij, gjë që duket qartë nga ndryshimet e vlerave të temperaturës nga sipërfaqja deri në thellesi.

- **Transparenca e ujit**

Transparenca e matur në ekspeditën e I në stacionin e referencës është 12 m i cili është një tregues i oligotrofisë së këtij liqeni, ndërsa në stacionin litoral transparenca është në vlerën 5m. Ujërat e liqenit janë të ngopura me oksigjen me vlera që variojnë 8 – 12 mg O/l. Liqeni i Ohrit për parametrin e transparencës paraqet gjendje oligotrofike.

- **Nevoja kimike për oksigjen**

Referuar të dhenave të marra nga ekspedita e parë nevoja kimike për oksigjen në stacionin e referencës paraqet vlerën 4.6 mg/l, ndërsa në stacionin litoral (për tre ekspedita të realizuara) në vlerën 9 mg/l duke e klasifikuar me cilësi mezotrofike.

- **Nevoja biokimike për oksigjen**

Vlera mesatare të nevojës biokimike për oksigjen për stacionin litoral është 5mg/l duke e vlerësuar në cilësi mezotrofike stacionin litoral.

- **Permbajtja e nitrateve**

Ky parameter rezulton të plotësojë kushtet për cilësi oligotrofike, pasi vlerat mesatare të monitorimit për stacionin litoral janë në vlerën 0.067mg/l, nën normën e lejuar <1 mgN/l.

- **Permbajtja e fosforit total**

Vlera mesatare e permbajtjes së fosforit total në stacionin litoral është në vlerën 0.01 mg/l, vlera kufi e oligotrofisë me tendencë mezotrofike, ku permbajtja e këtij parametri në stacionin litoral është 0.15 mg/l.

- **Permbajtja e Klorofilës A**

Nga të dhënat e monitorimit mbi sasinë e Klorofilës A në stacionin litoral vlerësojmë se ky stacion klasifikohet me cilësi mezotrofike. Monitorimi i stacionit të referencës është realizuar vetëm në një ekspeditë dhe duke qenë se monitorimi nuk është bërë i plotë nuk mund të bëjmë një klasifikim të cilësisë së ujërave të Liqenit të Ohrit për këto vit.

- **Tributaret**

(Lumi i Pogradecit Lumi Verdove Lumi Tushemisht) Pjesë e programit të monitorimit janë edhe tributaret të cilët derdhen në liqen, ku patjetër edhe cilësia e tyre ndikon në cilësinë e liqenit të Ohrit.

- **Temperaturat mesatare të ujërave variojnë në përputhje me ndryshimet sezonale.**

Ujërat e këtyre tre lumenjve vlerësohen alkaline me pH nga 7.43 - 8.12 dhe në vlera brenda normës së lejuar (<8.5)

- **Nevoja Biokimike per oksigjen**

Nevoja Biokimike per oksigjen eshte nje tregues i rendesishem per vleresimin e ndotjes. Permbajtja mesatare e nevojës biokimike per oksigjen ne Lumin e Pogradecit klasifikohet ne Klasen III – gjendje e moderuar, ne Lumin e Tushemishtit ne Klasen II – Gjendje e mire dhe ne Lumin e Verdoves vlere mesatare paraqitet te jete 14 mg/l duke e klasifikuar ne Klasen IV – Gjendje e varfer.

- **Permbajtja e amoniumit**

Percaktimi i permbajtjes se amoniumit ne kampione uji i percaktuar me metoden spektrometrike eshte parameter kryesor i klasifikimit ne klasa te cilesise se ujerave sipas DKU. Referuar vlerave mesatare Lumi i Pogradecit paraqitet ne gjendje te mire me nje vlere mesatare 0.34mg/l, ne Lumin e Verdoves permbajtja mesatare eshte 7.12mg/l duke e klasifi kuar kete stacion ne Klasen V – Gjendje e keqe dhe Lumi i Tushemishtit ploteson kushtet per ujera me cilesi te larte.

- **Permbajtja e nitriteve**

Referuar vlerave mesatare te monitorimit, Lumi i Pogradecit dhe stacioni i monitorimit ne Tushemisht klasifikohen si ujera ne gjendje te mire – Klasa II dhe Lumi i Verdoves si ujera me cilesi te varfer – Klasa IV.

- **Permbajtja e nitrateve**

Permbajtja e nitrateve per te tre stacionet e kampionimit rezulton te jete brenda normes se lejuar. Prania e nitrateve ne ujerat e lumenjve vjen kryesisht nga perdorimi i plehrave kimike ne bujqesi ne tokat rreth zones se kampionimit.

- **Permbajtja e fosforit**

Referuar rezultateve mesatare te monitorimit per permbajtjen e fosforit, Lumi i Pogradecit klasifikohet ne Klasen II – gjendje e mire dhe Lumi i Verdoves klasifikohet ne Klasen III – Gjendje e moderuar. Lumi i Tushemishtit vleresohet me ujera te nje cilesie te larte.

- **Permbajtja e fosforit total**

Referuar rezultateve mesatare te monitorimit per permbajtjen e fosforit total, tributaret vleresohen brenda normes se lejuar

**Lumi i Pogradecit**

Nr.	Parametri	Vlera mesatare vjetore	Norma	Klasifikimi
1.	NBO5	7 mg/l	< 7	Gjendje e varfer – Klasa IV
2.	Permbajtja e amonjakut	0.34 mg/l	< 0.6	Gjendje e mire – Klasa II
3.	Permbajtja e nitriteve	0.005 mg/l	< 0.12	Gjendje e larte – Klasa I
4.	Permbajtja e nitrateve	0.58 mg/l	< 4	Gjendje e larte – Klasa I
5.	Permbajtja e orto - fosfat-eve	0.018 mg/l	< 0.2	Gjendje e larte – Klasa I
6.	Permbajtja e fosforit total	0.025 mg/l	< 0.4	Gjendje e larte – Klasa I

**Lumi Verdove**

Nr.	Parametri	Vlera mesatare vjetore	Norma	Klasifikimi
1.	NBO5	14 mg/l	< 7	Gjendje e varfer – Klasa IV
2.	Permbajtja e amonjakut	7.12 mg/l	< 0.6	Gjendje e keqe – Klasa V
3.	Permbajtja e nitriteve	0.21 mg/l	< 0.12	Gjendje e varfer – Klasa IV
4.	Permbajtja e nitrateve	1.15 mg/l	< 4	Gjendje e mire – Klasa II
5.	Permbajtja e orto - fosfat-eve	0.36 mg/l	< 0.2	Gjendje e varfer – Klasa IV
6.	Permbajtja e fosforit total	0.46 mg/l	< 0.4	Gjendje e varfer – Klasa IV

**Lumi i Verdoves** referuar gjithe parametrave te mesiperm klasifikohet ne nje lum me cilesi te keqe ku nevoja biokimike per oksigjen dhe permbajtja e larte e amonjakut deshmojne per shkarkime urbane te cilat derdhen direkt ne lume pa asnje trajtim paraprak dhe kjo shtate kerkon te merren masa te menjehershme.

**Lumi Tushemishtit**

Nr.	Parametri	Vlera mesatare vjetore	Norma	Klasifikimi
1.	NBO5	3 mg/l	< 7	Gjendje e mire - Klasa II
2.	Permbajtja e amonjakut	0.017	< 0.6	Gjendje e larte - Klasa I
3.	Permbajtja e nitriteve	0.0026	< 0.12	Gjendje e larte - Klasa I
4.	Permbajtja e nitrateve	0.5	< 4	Gjendje e larte - Klasa I
5.	Permbajtja e orto - fosfat-eve	0.014	< 0.2	Gjendje e larte - Klasa I
6.	Permbajtja e fosforit total	0.017	< 0.4	Gjendje e larte - Klasa I

Lumi i Tushemishtit referuar parametrave te statusit kimik vleresohet ne ujera me cilesi te mire ne Klasen II.

**Burimi i informacionit:** Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2019, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Aqjencia Kombetare e Mjedisit (Faqja Zyrtare).

### 3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

#### 3.1 INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

##### Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundeson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimitet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet perberes të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndhmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshem të mjedisit.

##### Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit nga faktore të ndryshme, njerëzore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- **Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.**
- **Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”.**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar.**

- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”.**
- **Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura". I ndryshuar me:-Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008.**
- **Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”.**
- **Vendim i KM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.**
- **Vendim i KM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore”.**
- **Vendim i KM Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse”**
- **Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”**
- **Vendim i KM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.**
- **Vendim i KM Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror”.**
- **Vendim Nr. 417, date 25.06.2014 “Per miratimin e tarifave te lejeve te mjedisit”**
- **Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave”.**

#### **Shenim:**

Bazuar ne Ligjin Nr. 52/2020, date 30.04.2020 “Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011, “Per Lejet e Mjedisit”, te ndryshuar”, ky aktivitet, perfshihet ne listen e aktiviteve qe duhet te pajiset me leje mjedisore te tipit A ose B. *(Konkretisht ID 3.1.e. Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj.) dhe ID 5.4.c. Rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme, Kapaciteti kufi per Lejet e Mjedisit Tipi B: Të gjitha instalimet.*

### 3.2 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te subjektit "INFINIT" Shpk, NIPT: J74304623M, me seli ne Korce, Udenisht, fshati Memlisht, poligoni parafabrikat Guri i Kuq me ambjent me nr pasurie 731/48, zona kadastrale 2648 dhe me administrator Z. Kujtim Bregu. Ky subjekt, ka paraqitur kerkesen per hartimin e procedures se konsultimit me publikun prane AKM-se dhe do te aplikojte prane QKB-AKM per pajisjen me Leje Mjedisore te Tipit B per aktivitetin Prodhimi i produkteve prej betoni dhe Rikuperim i mbetjeve jo te rrezikshme. Objekti i vleresimit te ketij raporti eshte aktiviteti i Prodhimit te produkteve prej betoni (me kallep) qe perdoren si lende e pare per ndertim (blloqe te ndryshme, bordura, tuba betoni etj). Ky aktivitet ndodhet ne Qarkun Korçë, Bashkia Pogradec, Njesia Administrative Udenisht, fshati memlisht, poligoni parafabrikat Guri i kuq me ambjent me nr pasurie 731/48, zona kadastrale nr 2648. Aktiviteti ndodhet rreth 3.5 km ne vije ajrore, larg nga qendra e qytetit te Pogradecit dhe rreth 80m ne vije ajrore larg nga Liqeni i Ohrit. Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, ky aktivitet klasifikohet ne ID 3.1.e. Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikeve, paletave, etj.) dhe ID 5.4 pika c). Rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme. Të gjitha instalimet Leje Mjedisi Tipi B. Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, parashikon ndikimet ne mjedis qe mund te shkaktoje aktiviteti i prodhimit te produkteve prej betoni.

Ortofoto e vendodhjes se aktivitetit







Harta topografike e rajonit. Nomeklatura e shkalles 1:10000 (K-34-114-A-b-3)





Foto te aktivitetit



PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI DHE RIKUPERIMI I MBETJEVE JO TE RREZIKSHME.  
KORÇË, POGRADEC, N.J.A. UDENISHT, MEMLISHT, POLIGONI PARAFABRIKAT GURI I KUQ ME NR. PAS 731/48, ZK 2648.



Foto te makinerive, mjeteve te punes dhe pajisjeve



### **Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)**

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis” dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

### **Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.**

#### **Shkarkime ne uje**

Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera, te cilat lindin si rrjedhoje e pastrimit te siperfaqes ku ushtrohet aktivitetit i prodhimit te produkteve prej betoni dhe te larjes ose shpelarjes se kantierit nga rreshjet atmosferike. Ky aktivitet nuk shoqerohet me prodhim te ujerave te ndotura dhe si rrjedhoje nuk ka shkarkime te tyre. Ujerat e larjes ose shpelarjes se kantierit nga rreshjet atmosferike jane ujera te turbullt, me perberje te fraksioneve te imeta te tokes/inerteve, te tilla si rera dhe mund te kene edhe nje perqindje te vogel çimentoje te tretur. Keto ujera shkarkohen ne grope septike. Ne sheshin e aktivitetit, nuk magazinohen materiale te rrezikshme dhe si rrjedhoje nuk ka ndotje te ujerave nentokesore ose siperfaqesore nga kimikate te rrezikshme. Objekti dhe sheshi ne te cilin zhvillohet ky aktivitet jane te shtruara me beton dhe çakull.

### **Emetimet ne ajer**

Emetimet ne ajer nga ky instalim mund te vijne vetem nga pluhuri i reres nga lenda e pare e magazinuar, i cili mund te ngrihet nga faktoret klimatike. Gjithashtu, procesi i prodhimit shoqerohet me clirim zhurme por nuk vleresohet ne nivele te larta e shqetesuese per zonen (per kete subjekti ka kryer testimet nga laboratore te akredituar).

Shkarkimet spontane, nuk vleresohen me ndikime te rendesishme ne mjedis dhe ne komunitetin e zones. Pervet pluhurit te ngritur ne ajer nga era, ne kete ambient, mund te vleresohen edhe gazet qe shkarkohen nga makinerite e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit.

### **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga makineria e prodhimit te produkteve prej betoni (blloqe te ndryshme, bordura, tuba betoni, etj). Proçesi i prodhimit shoqerohet me çlirim zhurme por nuk vleresohet ne nivele te larta e shqetesuese per zonen (per kete subjekti te kryeje testimet nga laboratore te akredituar).

### **Ndikimi ne toke**

Proceset e punes nuk ndikojne ne toke, por zenia e nje siperfaqe toke nga instalimi dhe depozitimi i materialeve, eshte tashme nje fakt dhe nuk ndryshon gje vleresimi ne kete faze. Aktualisht, nuk demtohet me tej bimesia, nuk demtohet relievi as struktura e tokes, pasi nuk ka ndryshime ne instalim, as zgjerim te siperfaqes.

### **Ndikimi ne Biodiversitet**

Sipas verifikimeve ne portalin [asig.gov.al](http://asig.gov.al), kjo zone nuk bënë pjesë në zonat e mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitetin e mjedisit tokesor.

### **Ndikimi ne Mjedisin Social**

Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit te shtijes se blloqeve, pllakave per ndertim, konkurrences ne treg dhe uljes se çmimeve nga shitja direkt nga pika e shumices, etj.

### **Mbetjet e prodhuara**

Ky aktivitet nuk gjeneron mbetje nga prodhimi pasi si proces pune kryen aktivitet edhe ne fushen e menaxhimit te mbetjeve, perkatesisht te rikuperimit te mbetjeve jo te rrezikshme (mbetje inerte, çakull dhe beton). Mbetje te tjera mund te vleresohen jane ato urbane nga aktiviteti human, si plastike, qelq, materiale letre, metale, mbetje organike (paleta druri), te cilat depozitohen ne kontenierin e mbetjeve te ngurta urbane te zones te percaktuara nga NJQV.

#### **4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.**

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Ujerat që dalin nga aktiviteti janë ujera, të cilat lindin si rrjedhojë e pastrimit të sipërfaqes ku ushtrohet aktiviteti i prodhimit të produkteve prej betoni dhe të larjes ose shpëlarjes së kantierit nga rreshjet atmosferike. Ky aktivitet nuk shoqërohet me prodhim të ujerave të ndotura dhe si rrjedhojë nuk ka shkarkime të tyre. Ujerat e larjes ose shpëlarjes së kantierit nga rreshjet atmosferike janë ujera të turbullt, me perberje të fraksioneve të imeta të tokës/inerteve, të tilla si rera dhe mund të kenë edhe një përqindje të vogël çimentoje të tretur. Këto ujera shkarkohen në gropë septike. Në sheshin e aktivitetit, nuk magazinohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk ka ndotje të ujerave në tokësore ose sipërfaqesore nga kimikate të rrezikshme. Objekti dhe sheshi në të cilin zhvillohet ky aktivitet janë të shtruar me beton dhe çakull.

Emetimet në ajër nga ky instalim mund të vijnë vetëm nga pluhuri i reres nga lenda e parë e magazinuar, i cili mund të ngrihet nga faktorët klimatike. Gjithashtu, procesi i prodhimit shoqërohet me çlirim zhurme por nuk vlerësohet në nivele të larta e shqetësuese për zonën (për këtë subjekt ka kryer testimet nga laboratorë të akredituar).

Shkarkimet spontane, nuk vlerësohen me ndikime të rëndësishme në mjedis dhe në komunitetin e zonës. Përveç pluhurit të ngritur në ajër nga era, në këtë ambient, mund të vlerësohen edhe gazet që shkarkohen nga makineritë e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit.

Zhurmat që prodhohen vijnë kryesisht nga makineria e prodhimit të produkteve prej betoni (blloqe të ndryshme, bordura, tuba betoni, etj). Procesi i prodhimit shoqërohet me çlirim zhurme por nuk vlerësohet në nivele të larta e shqetësuese për zonën (për këtë subjekt të kryejë testimet nga laboratorë të akredituar).

Ky aktivitet nuk gjeneron mbetje nga prodhimi pasi si proces pune kryen aktivitet edhe në fushën e menaxhimit të mbetjeve, përkatesisht të rikuperimit të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje inerte, çakull dhe beton). Mbetje të tjera mund të vlerësohen janë ato urbane nga aktiviteti human, si plastike, qelq, materiale letre, metale, mbetje organike (paleta druri), të cilat depozitohen në kontenerin e mbetjeve të ngurta urbane të zonës të përcaktuara nga NJQV.

#### **5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.**

Ndikimi i aktivitetit në kushte normale funksionimi zgjat për aq kohë sa zgjat edhe aktiviteti prodhues, pra fare pak orë në ditë dhe sasi të vogla prodhimi i shkarkimesh. Ndikimi në mjedis zgjat për aq orë sa funksionon aktiviteti në ditë dhe aq ditë sa ai funksionon në një vit.

#### **6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS**

Ndikimi në mjedisin e zonës në kushte normale të punës, mund të përhapet në një distancë fare të ngushtë, me dhjetëra metra, kjo për shkak të perketës ndikimit të zhurmës, pasi ndikimi në ujera nëse do të shkarkohen në mjediset ujore mbi vlerat e lejuara, do të shtrinte ndikimin e tij deri në burimin ujor prites. Ujerat e gjeneruar nga aktiviteti nuk kanë ndotje kimike, por vetëm turbullirën me lenden e fraksioneve të imeta të materialeve inerte. Nuk shkarkohen substanca ose elemente të demshëm për mjedisin, si në ato ujor, për ajrin, tokën dhe për biodiversitetin.


## 7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike dhe per mjedisin. Mjedisi i ketij aktiviteti eshte me funksion si kantier prodhimi produktesh prej betoni qe perdoren si lende e pare per ndertim (bordura, blloqe te ndryshme, tuba betoni, etj). Ne rast te mbylljes se aktivitetit, do te merret ne konsiderate mundesia e rehabilitimit te plote te siperfaqeve dhe kthimin e peizazhit ne gjendjen e mepareshme. Per kete subjekti duhet te hartoje nje plan mbyllje te aktivitetit, qe duke u nisur nga strukturat e perkohshme, nuk paraqitet me kosto te larta.

## 8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

### Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit

Rolin dhe përgjegjësinë kryesore të rehabilitimit të mjedisit e ka subjekti zhvillues i punimeve, kjo mund të realizohet vetë ose nëpërmjet një subjekti nënkontraktor. Institucionet përgjegjëse për mbikqyrjen e punimeve rehabilituese, ecurinë e punimeve rehabilituese, mbikqyrjen e efekteve në mjedis, për raportimin e të dhënave të monitorimit të mjedisit nga subjekti, etj, janë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Njësia e Qeverisjes Vendore (Bashkia), si dhe vetë subjekti zhvillues/investitor nëpërmjet ekspertit ose subjektit nënkontraktor të përzgjedhur për këtë qëllim.



***Në mënyrë të përgjithshme paraqesim disa prej masave rekomanduese, të cilat zhvilluesi duhet t'i zbatojë për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis***

***Masa parandaluese të rekomanduara për ndikimet në ajër, ujëra, tokë dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta.***

**Ndër masa të tjera parandaluese, minimizuese, rehabilituese, përmirësuese të ndikimit në mjedis rekomandojmë:**

- Duhet te punohet sipas rregullores se kushteve teknike, nuk duhet te lejohen derdhje te karburanteve dhe lendeve te tjera djegese ne mjedisin e aktivitetit.
- Ne sheshin e aktivitetit, nuk duhet te magazinohen materiale te rrezikshme.
- Mjetet rrugore qe qarkullojne duhet te jene konform normave te percaktuara dhe te testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjeteve e te pajisura me certifikaten perkatese.
- Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin duhet të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet).
- Te rehabilitohet siperfaqja perreth objektit, duke u gjelberuar dhe duke krijuar nje efekt ndihmes ne reduktimin e zhurmes dhe te pluhurit.
- Te mirembahet sheshi i depozitimit, duke mos lejuar erozionin dhe shplarjen e materialit per ne burimin uJOR prites.
- Subjekti te mos shfrytëzoje burimet ujore apo ato tokesore te zones pa miratimin e autoriteteve perkatese me pare.
- Te pastrohet ne menyre periodike grpa septike e shkarkimit te ujerave te rreshjeve.
- Menaxhimi i integruar i mbetjeve inerte dhe llumrave te prodhuara gjate zhvillimit te aktivitetit.
- Te respektohen normat ne fuqi te shkarkimeve ne mjedis sipas VKM Nr. 177, date 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".
- Te mos punohet gjate oreve te vona, pasi prane ka objekte banimi, te cilat do te ndikoheshin nga niveli i zhurmes.

#### **Monitorimi i elementeve mjedisore.**

Monitorimi i cilësisë së mjedisit dhe i nivelit të elementëve ndotës të tij, shkarkimet në ajër, në ujë, në tokë dhe dëmtimi i mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kriterëve shkencore, përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizimit të mostrave të ujit dhe të tokës, ndërsa përsa i përket ndotjes së ajrit ai monitorohet direkt në terren. Procesi i monitorimit synon mbledhjen e të dhënave të nevojshme për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione midis lidhjes së kushteve të burimeve të ndotjes dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor ose ekonomik, me synim për të marrë masat e nevojshme për reduktimin e shkarkimeve dhe përmirësimin e cilësisë së elementeve të mjedisit.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore të hartuara dhe të ndërmarra.

Procesi i monitorimit në rang individual, sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit, është detyrë e shoqërisë investitore ose e nënkontraktorit për elementet, në të cilat ai ndikon. Sipas VKM Nr.1189. datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 mund të monitorohen nga vetë investitori. Monitorimi të kryhet për shkarkimet në ajër, zhurmat, cilësinë e burimeve ujore, si dhe për punimet e rehabilitimit.



## Procesi i Monitorimit

### Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu VI “Monitorim i gjendjes së mjedisit”;
- Ligji Nr. 10440, date 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, (Kreu V, Neni 20, Pika 4).
- VKM Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”.

### Baza ligjore për monitorim

Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
VKM nr.103 datë 31.03.2002	“Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra e kontrollit të tyre. i ndryshuar me: Udhëzimin Nr. 12 datë 15.06.2010
VKM Nr. 123, datë 17.2.2011	Per menaxhimin e zhurmave
VKM Nr. 313, dt. 09.05.2012	Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis


Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”. Investitori ose firma ndërtuese do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis vetëm gjatë fazës së punimeve dhe konkretisht elementët e mëposhtëm:

- Për ajrin mund të monitorojë Lëndën e Ngurtë Pezull (LNP) dhe zhurmat (dB).
- Për ujin mund të monitorojë Lëndën e Ngurtë Pezull (LNP), ph, temperaturë, Konduktivitetin, BOD dhe COD.

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe po ashtu të dorëzohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto, me analiza të niveleve të shkarkimeve në mjedis, masat e marra për reduktimin e tyre në mjedis, si dhe mënyrën e zbatimit.

## **9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të shteteve fqinje, madje në kushte normale, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin nderkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E MJEDISIT



Nr. 11099 Prot.

Tiranë, më 15.02 2014

Nr. identifikues 262

## ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

### Z. LAERT SHEHU

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

*E vlerësime për subjektin "INFINIT" Sllp  
për përmbledhjen fotelike të VKK-SE*


*Akordit: Prodhimi i produkteve prej bakeri  
dhe Rikuperimi i mbetjes jo të vezirshme*

*Veudodhja: Q. Korço, B. Pogradec, H. A. Udenisliq  
Krye Membru, Poligoni prodhues  
Guri i Kuq me adresat me ur pasurore  
731/4B, 2K 264B.*

MINISTRI

Lefter KOKA





MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



Qendra Kombëtare e Biznesit  
National Business Center

Numri serial: LN-2068-09-2016  
NUIS/NIPT: L62113034E

# LICENCË

Subjekti: Laert Shehu

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, Njësia Bashkiake nr.4, Rruga Xhanfize Keko, Pallati Andi Konstruksion, Hyrja nr.4, Apartamenti nr.8.

Kodi: III.2.A (1+2)      Kod tjetër:

Data e lëshimit: 13/09/2017      Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë  
Vlerësim i ndikimit në mjedis. Auditim mjedisor

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

*Evluatime për shpërndarjen "DRAFT" sipas parësive të përcaktuara në Dekretin nr. 144/16.  
Aktori i: Prokurimi i produkteve prej bambari dhe mbështetje  
mjetesh për të rindërtuar  
Vendodhësi: A. Hoxha, B. Pogorelec, H. A. Udekuajt, F. Kushi Memliçaj,  
përbërësi i Komitetit të Organizimit me nr. protokoll nr. 73/148,  
ZK 2648*

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënskrimi i sportelit: *Floriada*



Kjo certifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qënë person i tatueshëm.